



# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

|                                              |                                                                                                                |                                   |
|----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|
| Për:                                         | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës<br>Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës         |                                   |
| Kopje:                                       | Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë            |                                   |
| Përmes:                                      | Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MRL-së |                                   |
| Nga:                                         | Venera Çerkini, Udhëheqëse e<br>Departamentit Ligjor dhe Monitorim të<br>Komunave                              | Datë:<br>13.10.2020<br>Nr.020-746 |
| Zyrtaret përgjegjës:                         |                                                                                                                |                                   |
| 1. Zyrtari konfirmues i<br>vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për<br>Monitorim të Komunave                                               |                                   |
| 2. Zyrtari hartues i<br>vlerësimit ligjor    | Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për<br>monitorim të komunave                                                    |                                   |
| Lënda:                                       | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të<br>Komunës së Gjakovës                                                    |                                   |
| Lloji i aktit:                               | <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës                                                          |                                   |

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,


Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 112/02-22420 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale përmes procedurave të negocimit të ofertave

I miratuar më datë: 29.09.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.10.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

|                                            |                                                                                                        |                                  |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|
| Za:                                        | Ardian Gjini, gradonačelnik opštine Đakovica<br>Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica |                                  |
| Kopija:                                    | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini       |                                  |
| Preko:                                     | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a         |                                  |
| Od:                                        | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS                             | Dana, 13.10.2020.<br>Br. 020-746 |
| Odgovorni službenici:                      |                                                                                                        |                                  |
| 1. Službenik za utvrđivanje pravne procene | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština,                                              |                                  |
| 2. Službenik-ca za izradu pravne procene   | Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština                                                |                                  |
| Predmet:                                   | Potvrda zakonitosti akta opštine Đakovica                                                              |                                  |
| Vrsta akta:                                | <input type="checkbox"/> Odluka skupštine opštine                                                      |                                  |

Uvažani gradonačelnice,  
Uvaženi predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o administrativnim oblastima i odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

|                                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Odluka skupštine opštine 01 br. 112/02-22420 o davanju na dugotrajno korišćenje nepokretne imovine opštine putem postupaka pregovaranja o ponudama. |
| Usvojena dana, 29.09.2020. godine,                                                                                                                  |
| Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 02.10.2020. godine,                                                                                         |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta, ocenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravne efekte. Ministarstvo lokalne uprave, ostaje na raspolaganju opštini za svako dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVË

Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
 DT NR: 463102-22420  
 02.10.2020  
 DT NR: /2020  
 Datë: 29.09.2020

HYRJESE-ULAZNA-INCOMING  
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
 BEVILLI E KOSOVËS / VILADNOSTVA GOVERNMENT OF KOSOVO  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration  
 Ministry of Local Government Administration  
 Data: 02.10.2020  
 Datum:  
 Hyrja organizim: Nr. i Lendës: Shporta: Vlera:  
 -VI- 620-796

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) të Ligjit Nr. 03L/0-40 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 5, 6 pika 1.2, 8 pika 1.3 dhe nenin (11) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në nenin (2) të Rregullores (Ork) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.09.2020, pas diskutimit lidhur me pikën e 3 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale në kohëzgjatje 51 vite, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për**

**Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës për Dhënen në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale, përmes procedurave të negociimit të ofertave, Kompanisë HEINZE SLLP.K, në pjesën e parcelës 400-5 Zona Kadastrale Rogovë I, me sipërfaqe prej 25788 m<sup>2</sup> në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Afati kohorë për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale është në kohëzgjatje prej 51 viteve.
3. Qëllimi i dhënies në Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është Interesi Publik dhe përfuturi i Komunës së Gjakovës nga prona komunale.
4. Kompania HEINZE SLLP.K obligohet që t'ia paguaj Komunës qiranë mujore në vlerë prej 320€.
5. Ky vendim bën në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

- Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Kadastrë Gjeodezi dhe Pronë.
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- Shërbimit Profesional të Kuvendit.
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA ĐAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVË

HYREES-LIJAZNA-INFORMACIONE  
KOSOVA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PRANITIT LOKAL  
Ministertsi Lokalne Samouprave i Administracijo  
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date: 02.10.2020

| Ministria e Administrimit të Pranitit Lokal | Ministertsi Lokalne Samouprave i Administracijo | Ministry of Local Government Administration |
|---------------------------------------------|-------------------------------------------------|---------------------------------------------|
| Ministria e Administrimit të Pranitit Lokal | Ministertsi Lokalne Samouprave i Administracijo | Ministry of Local Government Administration |

71-020-746

Skupština Opštine - Đakovica  
01 Br. 263/02-22470 / 2020  
Dt. 29.09.2020

Skupština Opštine Đakovica, na osnovu člana 12.2 slova (d) Zakona br. 031 / 0-40 o lokalnoj samoupravi i člana 18 Statuta opštine Đakovica, člani 5, 6 tačka 1.2, 8 tačka 1.3 i člani 11 zakona br. 06 / L-092 o Davanju na korišćenje i razmeni Opštinske nepokretne imovine, u člani 23, Uredbe (Krk) br.09 / 2020 o utvrđivanju postupaka za dodelu na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, na sastanku održanom 29.09.2020, nakon rasprave u vezi sa 3. tačkom dnevnog reda: Naertom odluke o davanju na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine u periodu od 51 godine, odobrava sledeću:

### ODLUKU

Za

#### Davanje na dugoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine

1. Odobrava se predlog Predsednika Opštine Đakovica za davanje na dugoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine, kroz procedure pregovaranja o tenderima, Kompanije HEINZE LLC, u delu parcele 400-5 Katastarske Zone Rogova 1, sa Površinom od 25788 m<sup>2</sup> u vlasništvu Opštine Đakovica.
2. Rok za davanje na dugoročnu upotrebu opštinske nepokretne imovine je u trajanju od 51 godine.
3. Cilj davanja na korišćenje nepokretne imovine opštine je javni interes i korist opštine Đakovica od opštinske imovine.
4. Kompanija HEINZE LLC je dužna da mesečno plaća Opštini kiriju u iznosu od 320 €. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokolu kancelarije Ministarstva za Lokalnu Upravu i sedam dana nakon objavljivanja na sajtu Opštine.

#### - Odluka se šalje:

- Predsedniku Opštine,
- Ministarstvu za Lokalnu Samoupravu,
- Stručnoj Službi Skupštine Opštine,
- Direktorijatu za Katastar geodeziju i Imovinu
- Direktorijatu za Budet i Financije
- Arhivi

Predsedavajući Skupštine Opštine

g. Anton Šalja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



|         |                                                                                                     |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Data/nr | 21.09.2020 01-48501-2020                                                                            |
| Per     | Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës                                             |
| CC      | - Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës<br>- Arkivit                               |
| Nga     | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës                                                         |
| Lënda   | Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale prej 51 viteve |


Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.031-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 6 pika 1.2, nenit 8 pika 1.3 dhe neni 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 23 paragrafi 6, i Rregullore (Qrk) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 41 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datën 26.12.2008, me datën 21.09.2020 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

### PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miraton për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë prej 51 viteve, në pjesën e ngastrës 400-5, Zona Kadastrale në Rogovë 1, me sipërfaqe prej 25788 m<sup>2</sup>, sipas situacionit të datës 28.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është afatgjatë prej 51 viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është interesi publik dhe përlitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.
4. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes negociatave të kryetarit të komunës në harmoni me nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe të nenit 23 paragrafi 6, i Rregullore (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Bashkangjitur në këtë Propozim vendimi janë:
  - Certifikatat mbi pronësinë;
  - Ofertën e negociuar, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
  - Kërkesa e paraqitur nga palët e interesuara për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së bashku me dokumentacioni përfjellës.

Me respekt!



Për: zt. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës Gjakovë

Nga: Fitim Hoti - Drejtor i Kompanisë "Heinze" Shpk, me seli në fshatin Rogovë, Komuna Gjakovë, e cila identifikohet me nr. të biznesit 601137525.

Lënda: Kërkesë për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale.

Data: 23/10/2019

### Hyrje

Kompania Heinze sh.p.k. është themeluar në vitin 2014, investitor të kompanisë janë: kompania gjermane Heinze Gruppe, Fitim Hoti dhe Mehmet Kelmendi mërgimtarë në Gjermani, kompania aktivitetin e ushtron në fshatin Rogovë, në objektin dhe tokën e njërit nga pronarët zt. Fitim Hoti.

Aktiviteti kryesor i kompanisë është prodhimi i pjesëve të plastikës që kryesisht përdoren në ndërtimari në sektore të ndryshme të industrisë së lehtë, ku sod kemi rreth 80 artikuj të plastikës në Prodhim.

### Të dhënat kryesore financiare të Heinze Sh.p.k.

Që nga themelimi në fund të vitit 2014, kompania Heinze sh.p.k ka rritur afarizimin e saj, ka shtuar numrin e punëtorëve, ka rritur prodhimin dhe shitjet, po thuajse të gjithë fitimin e gjeneruar e ka riinvestuar në makineri, objekte dhe asete tjera.

Sic mund të shihet në të dhënat më poshtë, kompania Heinze sh.p.k., është një kompani në rritje të vazhdueshme në të gjithë parametrat ekonomik dhe poashtu shëndrruar në kontribues të rëndësishëm në të hyrat e buxhetit të Kosovës përmes shumë llojeve të tatimeve.

Poashtu mbi 95% e shitjeve të kompanisë eksportohen jashtë Kosovës si: Gjermani, Zvicerr, Dubai, Bullgari e shumë shtete tjera.

Kompania jonë aktualisht ka të punësuar 22 punëtorë, të cilët ka siguruar vend pune stabil dhe me të ardhura të qëndrueshme.

Në vitin 2019 si pjesë të zgjerimit të linjave të prodhimit kompania ka ndërtuar një objekt të ri në pronë private.

Tabela 1. Treguesit kryesor financiar të Heinze sh.p.k.

në €

| Viti         | Investimet<br>ne asete | Shitjet   | Tatimi ne<br>fitim | Tatimi ne<br>qera | Pagat bruto blerje | TVSh ne<br>blerje | TVSh ne<br>shitje | Numri i<br>punëtorëve |
|--------------|------------------------|-----------|--------------------|-------------------|--------------------|-------------------|-------------------|-----------------------|
| 2014         | 10,507                 |           |                    |                   |                    |                   |                   |                       |
| 2015         | 69,072                 |           |                    | 2,208             |                    |                   |                   |                       |
| 2016         | 296,222                |           |                    | 2,208             |                    | 12,412            |                   | 1                     |
| 2017         | 198,585                | 1,784,168 | 54,842             | 2,208             | 141,572            | 44,296            | 24,296            | 2                     |
| 2018         | 282,712                | 2,357,104 | 79,588             | 2,208             | 157,587            | 55,725            | 70,001            | 2                     |
| Shtator 2019 | 852,218                | 1,817,293 | 47,132             | 2,208             | 126,910            | 66,196            | 28,941            | 2                     |
| Total        | 1,709,315              | 5,958,565 | 181,562            | 11,040            | 426,069            | 178,629           | 123,238           |                       |

### Planet për zgjerim të biznesit

Meqenëse kompania jonë ka përparësi që është në kontakte direkte me kompani të mëdha ndërkombëtare, aktualisht jemi në kontakt serioz me disa partnerë tanë për fitimin e tri projekteve shumë serioz në fushën e prodhimit të produkteve të ndryshme në sektorin e ndërtimit:

1. Projekti për prodhimin e Shportave të ndryshme të plastikës për mbeturina (kontejnerave të vegjël).
2. Linja e prodhimit me ekstrudera, kanalinat dhe profilat e ndryshme të plastikës që përdoren në sektorin e ndërtimit.
3. pasi që prodhimin e shumë produkteve të plastikës që prodhojmë për sektorin e ndërtimit.

Jemi në projektim të linjes për prodhimin e fasadës, mallterëve (llaqeve) dhe ngjitsave të ndryshme të qeramikës,

## Shporta per mbeturina (kanta)

| Description              | Quantity | Costs     | Total costs |
|--------------------------|----------|-----------|-------------|
| JU1600 / 14600C          | 2        | 580.000 € | 1.160.000 € |
| JU1080 / 10600D          | 5        | 475.000 € | 2.375.000 € |
| Chiller                  | 3        | 95.000 €  | 285.000 €   |
| Hall 3.000m <sup>2</sup> | 1        | 900.000 € | 900.000 €   |
| Crane                    | 1        | 150.000 € | 150.000 €   |
| Transformer (230kW/JU)   | 1        | 200.000 € | 200.000 €   |
| Silo 23 to               | 6        | 35.000 €  | 210.000 €   |
| Tools                    | 6        | 400.000 € | 2.400.000 € |
| Compressor               | 1        | 200.000 € | 200.000 €   |
| Forklifts                | 4        | 30.000 €  | 120.000 €   |
|                          |          |           |             |

**8.018.000 €**

## Linie e prodhimit me ekstruder (profila te ndryshme)

| Description              | Quantity | Costs     | Total costs |
|--------------------------|----------|-----------|-------------|
| Extruder 150 kg/h        | 2        | 175.000 € | 350.000 €   |
| Tools                    | 4        | 25.000 €  | 100.000 €   |
| Hall 1.500m <sup>2</sup> | 1        | 280.000 € | 280.000 €   |
| Crane                    | 1        | 20.000 €  | 20.000 €    |
| Silo 8 to                | 1        | 15.000 €  | 15.000 €    |

**765.000 €**

## Linie prodhimeve te izolimeve, fasades, mallterave dhe ngjitsave te ndryshme

| Description              | Quantity | Costs     | Total costs |
|--------------------------|----------|-----------|-------------|
| Maqina                   | 1        | 120.000 € | 120.000 €   |
| Chiller                  | 1        | 10.000 €  | 10.000 €    |
| Hall 1.000m <sup>2</sup> | 1        | 200.000 € | 200.000 €   |
| Crane                    | 1        | 20.000 €  | 20.000 €    |
| Silo 23 to               | 4        | 12.000 €  | 48.000 €    |
| Compressor               | 1        | 20.000 €  | 20.000 €    |
| Forklifts                | 1        | 20.000 €  | 20.000 €    |
| Palett winder            | 4        | 3000      | 12.000 €    |

**450.000 €**

Përfitim i nga realizimi i këtyre projekteve:

- Investimi në implementimin e këtyre 3 projekteve planifikojmë shumë shpejt fillimin e investimeve dhe realizimit, dhe të jetë mbi 9 Milion €
- Me investimin në këto tri projektet planifikojmë që shitjet qarkullimin e kompanisë do të arrijnë rreth 18 000 000 milio € në vit, mbi 90% do të jenë eksport jashtë Kosovës.
- Me realizimin e këtij projekti do të hapen 180 vende pune

Për zgjerimin e linjave të prodhimit dhe realizimin e investimeve të planifikuara për kompaninë është e domosdoshme siguri i një lokacioni/toke ku do të ndërtohen objektet e reja.

Për këtë qëllim ne kemi identifikuar parcelën kadastrale P-70713071-04001, zona kadastrale Rogovë, klasa 4, shfrytëzimi aktual kullosë, në vendin e quajtur Zall i Drinit, pronë e shoqërore e Kuvendit Komunal Gjakovë.

Sipërfaqja e tërësishme e lokacionit është 151656 m<sup>2</sup> (15.2 ha), nevojat e biznesit tonë janë për 30000 m<sup>2</sup> (3 ha).

#### Kërkesë

Duke marrë parasysh arsyetimet e dhëna më lartë, interesin dhe përfitimin e përgjithshëm që pritet të sjellin investimet e lartëcekura, kërkojmë mirëkuptimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, që të aprovoj kërkesën tonë për dhënie në shfrytëzim për nevojat e kompanisë Heinze sh.p.k. sipërfaqen prej 3 ha në vendin e lartë cekur.

Modalitetet, procedurat, kohëzgjatjen dhe kushtet tjera të kontratës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë jemi të gatshëm të negociojmë me Kryetarin e Komunës sipas ligjit dhe rregullave në fuqi.

Me respekt,

Parashtuesi i kërkesës: Fitim Hoti – Drejtor i "Heinze" sh.p.k.

Nr. Personal: 2000835237

Rogovë, Gjakovë 23.10.2019

fhoti@heinze-shpk.com

tel. +383 44 116 490

**KOMUNA GJAKOVË**  
**-Për Kryetarin Z.Ardian GJINI-**

**Lënda : Plotësim kërkesë-oferte për marrjen- dhënjën në shfrytëzim të paluejtshmerisë së Komunës e cila gjindet në fshatin Rogovë-Gjakovë për investimin në ndërtimin e hallave të prodhimit.**

Në bazë nenit 8 par.1 pika 1.3. nenit 11 lidhur me nenin 5 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës.firma HILINZI sh.p.k. me seli në Rogovë-Komuna Gjakovë të cilën e përfaqëson Drejtori Filim Hoti parashtronë

**PL OT SIM K Ë R K E S E**

Firma HILINZI sh.p.k. me seli në Rogovë Komuna Gjakovë ka shpreh interes për marrjen në shfrytëzim të pronës së Komunës së Gjakovës dhe lidhur me këtë ka parashtrur Kërkesë me datën 30.10.2019.

Në kërkesë janë dhënë të gjitha të dhënat për firmë njëkohësishtë është identifikuar parcella kadastrale me nr.P-707113071-04001 e cila parcelë tani ka nr. ngastresë P-70713071-00400-5 ZK Rogovë 1 në vendin e quajtur ZALLI DRINIT.

Në pjesën e kësaj parelle në sipërfaqe prej 2-3 ha e cila kufizohet me fabriken HILINZI sh.p.k. e cila prodhon pjesë të plastikes për ndërtimtari dhe sektoret të ndryshme të industrisë së lehtë,planifikohet investimi për ndërtimin e dy objekteve prodhuese të cilët do të bashkangjiten objektit ekzistues në sipërfaqe prej 3000 m<sup>2</sup> dhe 1500 m<sup>2</sup>.

Kapitali investues për ndërtimin dhe funksionalizimin e prodhimit është sqaruar në kërkesën e paraqitur.

Duhet cekur se investimi në këtë projekt prodhues është i përzier me kapital privat të Kosovës dhe firmës nga Gjermania emrin e të ciles e mban firma e cila ka parashtrur kërkesën.

Me këtë plotësim kërkesë të çiles in bashkangjesim dokumenta plotësues jipin  
këto sqarime:

1. Veprimtaria prodhimi nuk është e rezikshme për banorët e as për të punësuarit.
2. Objektet do të ndertohen në afërsi të objektit ekzistues
3. Në këtë lokacion ku do të ndertohen objektet prodhuese nuk ka levizje të banorve e as rrug për komunikacion.

Bashkangjitur këtëj plotësimi të kërkesës ju dërgoj:

- 1.Projektin ideor të objekteve,
- 2.Raportin e vlersimit të ndikimit në mjedis
- 3.Certifikaten e pronësisë
- 4.Kopjen e planit

*Duke I bashkangjitur plotësimet e kërkesës mbesë me shpresë se në afat sa ma të shkurtur do të mirret Vendimi për dhënjën e pronës së Komunës në shfrytëzim afatgjatë.*

*Me nderime*

*Gjakovë,08.06.2020*

Parashtruesi I kërkesës,  
HEINZE sh.p.k. Rogovë-Gjakovë  
Drejtori  
Fitim HOTI



KOMUNA GJAKOVË  
-Për Kryetarin Z.Ardian GJINI-

*Lënda : Plotësim kërkesë-oferte për marrjen- dhënjen në shfrytëzim të paluejtshmerisë së Komunës e cila gjindet në fshatin Rogovë-Gjakovë për investimin në ndërtimin e hallave të prodhimit.*

Në bazë nenit 8 par.1 pika 1.3. nenit 11 lidhur me nenin 5 të Ligjit nr 06/1 -092 për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës firma "HINZI" sh.p.k. me seli në Rogovë-Komuna Gjakovë të cilen e përfaqeson Drejtori Fitim Hoti parashtronë

**PL OT SIM K È R K E S E**

Me këtë plotësim kërkesë të ciles ia bashkangjesim dokumenta plotësues t: vlerësim nga kompanit të licencuara japim këto "opprime":

Bashkangjitur këtëj plotësimi të kërkesës ju dërgoj:

- 1.Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis nga hartuesi i licencuar "N.P.N." "REALPROJECT"-Gjakovë
- 2.Vlerësimi i pronës i hartuar nga kompani e licencuar për investitorin.

Nga Raporti i Vlerësimit pika 4.2 Lokacionin i pronës(harta-faqja 9)dhe nga pika 8. Foto te pronës (faqja 12 deri 16) të Raportit vlerësues ku edhe vetë Vlerësuesi konstaton që për të funksionalizuar këtë pronë-paluejtshmeri për të pregaditë për realizimin e investimit është i nevojshëm investimi i konsiderueshëm.

Parecella është demografisht e dëmtuar e që është konstatuar edhe nga inspektimi i përfaqësuesve të Komunës.

Duke I bashkangjitur plotësimet e kërkesës mbësë me shprehë së në afat së më të shkurtur do të muret Vendimi per dhënjen e pronës së Komunës ne shfrytëzim afatgjatë.

Me nderime

Gjakovë, 13.08.2020

Parashtruesi i kërkesës,  
HEINZE sh.p.k. Rogovë-Gjakovë

Drejtori

Fitim HOTI



I autorizuari  
Avokat Idriz Daci





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna e Gjakovës

01nr 963/02-20993

Dt: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 5, 6 pika 1.2, nenit 8 pika 1.3 dhe neni 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 23 paragrafi 6, të Rregullore (Ork) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nxjerrët kjo:

**OFERTË E NEGOCIUAR,  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PREJ 51 VITE PRONËN E PALUAJTSHME  
TË KOMUNËS NË PJESËN E PARCELËS ME NUMËR 400-5, ZONA KADASTRALE NË  
ROGOVË 1, ME SIPERFAQE PREJ 25788 m<sup>2</sup>.**

Komuna e Gjakovës pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të bashkangjitur në kërkesë për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale me numër 400-5, Zona Kadastrale në Rogovë 1, me sipërfaqe prej 25788 m<sup>2</sup>, sipas situacionit të datës 28.07.2020, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për të propozuar çmimin përfundimtar tek ofertuesi dhe pas negociimit palët u dakorduan së çmimi mujor të jetë prej 320 euro, ndërsa vjetore 3.840.00 euro.

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini



Drejtori i Kompanisë Heinze SH.p.k

Fitim Hoti



## RAPORT I VLERËSIMIT TË NDËRIMIT NË M.JEDIS


Objekti: Halla prodhuese për llaqe të fasadeve dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC

Investitor: FITIM HOTI, përfaqësues i firmës HEINZE SH.P.K. Rogovë

Nr. Ngastres: 400-I

Z.K. Gjakovë - Rogovë I

HARTUESI I RAPORTIT: N.P.N "REALPROJEKT" - GJAKOVË



Gjakovë, gusht 2020



# RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Objektet:** Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC

**Investitor :** Fitim Hoti, përfaqësues i firmës HEINZE SH.P.K. Rogovë

**Nr. Ngastres:** 400-1, Z.K. Gjakovë – Rogovë I

## HYRJE

Ky dokument paraqet një raport të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për ndërtimin dhe operimin e objekteve : Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC dhe infrastrukturës përcjellëse, ndikimet e tyre të mundshme në mjedis dhe efektet kumulative nga projektet e kësaj natyre në lokacionin pranë zonës , në ngastrën kadastrale 400-1 në Z.K.Gjakovë – Rogovë I

Ky Raport është përgatitur sipas kërkesave dhe detyrimeve të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës, veçanërisht sipas Udhëzimit Administrativ për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale nr. 01/2017, dhe Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit dhe të punimeve të cilat do të kryhen, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis.

Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis – janë komponentët kryesorë të këtij raporti.

## **I. Qëllimi dhe Arsyetimi i Projektit**

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që gjatë fazave të ndryshme të realizimit të jetë brenda parametrave të lejuar mjedisor, që të ndërtohet, funksionalizohet dhe operoj objekti: Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC në fshatin Rogovë, të nevojshëm për krijimin e hapsirave për këtë destinim si dhe mundësimin e aktivitetit të tyre afarist. Ky elaborat do të studioj një mori aktivitete në dhe rreth projektit në fjalë, analiza dhe të gjeturat nga ato do t'i adresoj në rrugë të duhur dhe do të sugjeroj masat e nevojshme në mënyrë që projekti të jetë brenda parametrave të lejuar mjedisor.

Ky projekt, parasheh ndërtimin dhe funksionalizimin e objektit: Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC, në parcelen 400-1 ZK Rogovë, e cila ka sipërfaqe të tërësishme prej 15.2 ha, por që për ndërtimin e këtyre 2 objekteve nevojitet sipërfaqe rreth 3.0 ha, për secilin objekt së bashku me elementet përcjellëse nga 1.0-1.5 ha.

## **II. Përshkrimi i lokacionit të projektit dhe kushteve mjedisore**

Lokacioni në të cilin planifikohet të ndërtohen objektet prodhuese me infrastrukturën përcjellëse gjendet në parcelen nr.400-1 në zonën kadastrale Gjakovë – Rogovë I.

Plani ideor me situacion, në të cilin parashihet të ndërtohet objekti: Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC, e ku do të paraqiten të dhënat dhe struktura e projektit në fjalë do të jetë i bashkangjitur në raport. Zona në të cilën planifikohet të ndërtohet objektet, është zonë kryesore pa infrastrukturë të kompletuar urbane.

Gjendja e terrenit – lokacioni në të cilin do të ndërtohet objekti: Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC

Ngastra në fjalë, respektivisht tereni ka konfiguracion të çrregullt me një ramje të terrenit (për të cilën gjë duhet intervenuar paraprakisht duke e nivelizuar në pozitë të rrafshët).

Gjatë punës me gërmues dhe kamiona transportues duhet të merren masa adekuate në mënyrë që të mos krijohet pluhur dhe të mos nxjerret dheu në rrugët publike, për këtë investitori do të marrë masa zbutëse në mënyrë që ndotja të mos ndodhë.

Duke pasur parasysh karakterin për banim të zonës, në këtë raport nuk paraqesim hollësi dhe të dhëna të tjera për gjendjen e mjedisit në zonë, florën, faunën dhe peizazhin.

Megjithatë, janë identifikuar, analizuar dhe përmbledhur në tabelën vijuese të gjitha ndikimet si dhe janë propozuar masat e nevojshme zbutëse për ndikimet signifikante.

|                                | Faza e përgatitjes/ndërtimit |
|--------------------------------|------------------------------|
| Ajri                           | x                            |
| Zhurma                         | x                            |
| Cilësia e ujit                 | x                            |
| Menaxhimi i Mbeturinave        | x                            |
| Kontaminimi i tokës            | x                            |
| Materjet e rrezikshme për jetë | x                            |
| Trashëgimia kulturore          | x                            |
| Ndikimi vizual                 | x                            |

- Baze për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe ndikimet në të është Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (03/L -160), respektivisht nenet 3 dhe 4 lidhur me treguesit dhe përcaktimin e standardëve bazë në përcaktimin e standardeve të cilësisë në mënyrë që ndikimet në cilësinë e ajrit të jenë brenda vlerave maksimale të lejuara për okside të sulfurit, oksideve të azotit, monoksidit të karbonit , oksiduesve fotokimik siq është ozoni.
- Zhurma duhet të vlerësohet dhe të jetë në harmoni të plotë me Ligjin për mbrojtjen nga zhurma (02/L-102), dhe vlerat e saj të mos tejkalojnë kufijtë e lejuar, mundësisht gjenerimi i saj në burim të jetë më i ulët në mënyrë që të mos afektohen qytetaret. Makineria e angazhuar gjatë kohës së rrenimit duhet që t'i përmbahet orarit të punës 07.00-17.00, pas kësaj kohe duhet të jetë pasive, ndërsa vlerat e zhurmës në dB nuk duhet të kalojnë kufijtë prej 75dB në muret e objekteve me të afërta.

- Në dhe rreth hapsirës në të cilën do të kryhen aktivitetet përgatitore për ndërtim si dhe gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të hallave prodhuese duhet të kihet kujdes në menaxhimin e ujrave të zonës.
- Gjatë fazës përgatitore dhe ndërtimeve duhet pasur kujdes që punimet të kryhen në harmoni me ligjin për ruajtjen e tokës, pra nuk lejohet në asnjë mënyrë që të ketë rrjedhje të karburantëve dhe lubrifikantëve nga maqineritë e angazhuara në dhe rreth hapsirës së projektit.
- Nëse gjatë ndërtimit haset në ndonjë objekt specifik atëherë duhet që ai të trajtohet sipas ligjit në fuqi për trashëgimin kulturore.
- Gjatë kohës së përgatitjes së vendpunishtës dhe gjatë kohës në të cilin kryhen ndërtimet duhet që hapsira e paraparë për ndërtim të mos jetë shqetsuese vizuelisht/e papranueshme vizuelisht për qytetarët.

## 1.0 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Arkitektura e objektit do të jetë në funksion të objektit. Hallat do të ndërtohen nga materialet e çelikut (me kapriata – traje mbajtëse) dhe shtylla të çelikut të kombinuara me elemente të parafabrikuara për mbylljen e objektit si dhe mbulimin me llamarinë të valëzuar. Do të përdoren materiale termoizoluese të cilat do të jenë në funksion të mbrojtjes dhe eficiencës së energjisë. Materialet e parapara për punimin e fasadave dhe mbulimin e hapësirave tjera do të jenë kombinim i tërësishëm i materialeve bashkëkohore.

Në kuadër të objekteve do të jenë edhe hapësirat-krthinat për administratë të cilat poashtu do të ekzekutohen me materiale bashkëkohore.

### Sipërfaqja e gjelbrimit

Në kuadër të lokacionit është paraparë poashtu edhe një sipërfaqe e konsiderueshme gjelbëruese pasi që terreni është i rrethuar kryesisht me livadhe dhe kullosa.

### Vendosja e kontejnerave

- Do të parashihet lokacioni për vendosjen e kontajnerëve në një pozitë të tillë që nuk pengon qarkullimin e njerzve dhe nuk ndikon në cilësinë e jetesës së banorëve përreth.
- Ndërsa për transportuesit e mbeturinave urbane nga ana e kompanive publike, qasja për marrjen dhe transportimin e tyre do të bëhet nga ruga e paraparë – para objektit.

## 2. PËRSHKRIMI I PROCESIT, PAJIMET E NEVOJSHME PËR PËRGATITJEN E TERRENIT DHE KRYERJEN E NDËRTIMEVE.

Destinimi i këtij projekti është ndërtimi i objekteve Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC, nga investitori sh.p.k. HEINZE.

Veprimet kryesore gjatë gërmimeve dhe përgatitjes së terrenit si dhe ndërtimit të objektit do të jenë operimet me makineri të rëndë si: gërmues të terrenit dhe makineri transportuese për largimin e materjaleve ndërtimore dhe dheut, si dhe dhe sjelljen e materjaleve ndërtimore të nevojshme për ndërtimin e objekteve.

Pajimet për ndërtim konsistojnë në angazhimin e makinerive të ndryshme të nevojshme gjatë kryerjes së ndërtimeve në vend punishte.

Pajisjet dhe mjetet të cilat do të përdoren për mbarëvajtjen e punimeve në ngritjen e objektit në fjalë janë si në vijim:

- Rrethoja e punishtes
- Hyrjet daljet për automjete dhe makineritë e angazhuara.
- Kontajnerë për mjete pune dhe kontajnerë për zhveshtore
- Kontajnerë për punëkryerës dhe mbikqyrës
- Gërmues të terrenit me qëllim të hapjes së themeleve
- Kontajnerë i mbetjeve inerte
- Kamiona transportues për largimin e dheut nga lokacioni në fjalë, si dhe sjelljen e materialit në vendndërtim.
- Autopompa dhe hapsira për pastrimin e automjeteve para se ato të lëshojnë vendpunishten,
- Gropa septike me separator me dimensione: 2.5x4x1.5 m.
- Shenjëzimet lidhur me ndalim kalime dhe ndalim hyrje dhe sinjalizime tjera sipas legjislacionit në fuqi.
- Autolarje për pastrimin e gomave të makinerisë së angazhuar, në mënyrë që të mos nxjerret dheu jashtë lokacionit
- Aparatë për fikjen e zjarrit dhe kutia me rërë dhe lopata si dhe,
- Ndriçimi i vendpunishtes.

Faza përgatitore e vendpunishtës si dhe faza e ekzekutimit të punimeve duhet të realizohet me profesionalizëm të lartë dhe në harmoni të plotë me legjislacionin vendor në fuqi për emisione dhe imisione në dhe rreth zonave të banueshme dhe afariste.

### 3.0 IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Lokacioni në të cilin do të realizohen fazat e përgatitjes së terrenit për ndërtim, kryerja e ndërtimeve dhe faza operationale ofron mundësi të shumta për gjenerimin e ndotjeve në mjedis dhe në prishjen e cilësisë së jetesës për ambientin në këtë lokacion. Andaj, investitori në bashkëpunim me punëkryesit dhe projektuesin obligohen që në të gjitha fazat e kryerjes së punimeve në dhe rreth objektit të operojnë brenda ligjeve dhe rregullave në fuqi, me qëllim që ndotja e mjedisit të jetë brenda normave të lejuara.

Dizajni, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e kompleksit në fjalë kanë ndikim të madh në mjedis dhe në resurse natyrore. Mbetet tejet sfiduese që të ndërtohen objekte të cilat shfrytëzojnë sasira minimale të energjisë dhe që prodhojnë ndotje të vogël dhe njëkohësisht funksionojnë me një standard të lartë, shëndet dhe siguri për punëtorët që do të punojnë në të dhe nuk ofrojnë shqetsim për banorët përreth.

Shfrytëzimi i energjisë dhe ujit në sasira më të vogla në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit duke përfshirë edhe atë të operimit do të ndikojë që ndikimet në mjedis të jenë më të vogla dhe të reduktohen shpenzimet operationale.

Burimet më të ndotjes gjatë fazës së përgatitjes së ndërtimeve dhe konstruktimit janë: pulhuria, zhurma dhe mundësit e rrjedhjeve aksidentale të cilat do të shpërndahen në kontaminimin e tokës dhe hapsirave përreth.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të hapjes së dheut për themele të objektit mund të vie deri tek rritja e emisioneve të gazrave nga makineria e angazhuar për gërmim dhe transportim, me ç'rast mund të vie deri të rritja e ndotjeve dhe ulja e cilësisë së ajrit për banorët e Rogoves në përgjithësi dhe në veçanti për banorët e lokacionit në fjalë. Gjatë fazës së ndërtimeve pritet të ketë emisione në ajër të cilat lirohen nga makinerit punuese dhe transportuese në dhe rreth lokacionit të paraparë si dhe substancat apo lëndët e përdorura të cilat mund të emitojnë, si: dioksid karboni (CO<sub>2</sub>), monoksid karboni (CO), (CH<sub>4</sub>), (N<sub>2</sub>O), (SO<sub>2</sub>), amoniak (NH<sub>3</sub>), (HCl), (NO<sub>x</sub>) si dhe komponime të avullueshme organike (VOC).

Gjenerimi i zhurmës e cila në burim mund të kalojë vlerat maksimale të lejuara, ndërsa në objektet më të afërta mund të arrij vlera të cilat mund të sillen në kufijtë e lejuar, akumulimi i mbeturinave të ngurta dhe mundësia e rrjedhjeve aksidentale.

Gjatë procesit të gërmimit mund të vie deri të rrjedhje aksidentale e karburantit, lubrifikantëve apo ndonjë materie tjetër të dëmshme, ndotje e cila mund të kontaminojë tokën dhe gjatë reshjeve eventuale mund të ketë shpërndarje dhe ujrat të depertojnë në ujra nëntokësor.

Gjatë gërmimit, makineritë apo kamionat duhet të pastrohen para se të lëshojnë vendpunishten, pra të bëhet larja e e rrotave dhe me këtë krijohet ujë i ndotur i cili duhet të grumbullohet në njësin për trajtim dhe ky ujë duhet të largohet nga kompanitë të

cilat janë të licencuara për trajtim të ujrave të ndotura, nëse kemi mjedhje të lëngshme duhet që kjo të pastrohet me karbon absorbues.

Mbeturinat e ngurta dhe gjenerimi i tyre janë të zakonshme në të gjitha fazat si: përgatitje, rënim apo ndërtim dhe, për këtë kërkohet që trajtimi i tyre të jetë konform ligjit të mbeturinave.

Ndikime në kualitetin e ujrave mund të paraqiten nga shpëlarja e rrugëve nga të reshurat dhe mbajtja e higjienes, shpëlarja e ndonjë derdhje aksidentale të karburantëve dhe lubrifikantëve që përdoren nga makinerit e angazhuara në kryerjen e punimeve.

**Flora dhe Fauna** –Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë nuk është signifikant. Natyra e lokacionit ka mundësuar që flora dhe fauna e zonës që moti të fragmentohet dhe fauna është përshtatur me kushtet e reja urbane.

Projekti i rehabilitimit do të ketë disa ndikime të përkohshme mbi vendin e ndërtimit ku dheu do të hiqet dhe dheu i sipërm do të rivendoset. Gjatë procesit mikro-ekosistemi do të trazohet pa ndonjë ndikim serioz afat-gjatë në qoftë se ndërmerren masat e nevojshme gjatë proceseve të rehabilitimit dhe gjatë mirëmbajtjes siç është rekomanduar më parë.

Andaj, projekti në fjalë ofron shqetsime të moderuara në mjedis gjatë fazës së konstruktimit ndërsa në fazat e mëvonshme do të vie deri tek stabilizimi i biodiversitetit përmes krijimit të hapsirave të gjelbërta dhe për një numër të faunës do të krijohen kushte për krijimin e habitateve të reja.

**Zhurma dhe Emetimi i Pfluhurit** - Gjatë periudhës të rehabilitimit aktivitetet si lëvizja e mjeteve gërmuese dhe veprimet e makinerive të rënda mund të ndikojnë tek njerëzit që jetojnë pranë zonës, ata që jetojnë në dhe rreth perimetrit të ndërtimit. Megjithatë keto shqetësime do të jenë me efekte të kufizuara afat-shkurtra gjatë kohës së gërmimeve dhe transportimit të inerteve si dhe sjelljes së materjaleve ndërtimore në vendndërtim.

**Mbeturinat që gjenerohen gjatë ndërtimit,** – Kemi të bëjmë me mbeturina ndërtimore të cilat dalin nga procesi i ndërtimeve, respektivisht materjale që teprojnë gjatë ndërtimit apo ato që dëmtohen pariparueshëm për t'u futur në ndërtim.

Në aspektin e gjenerimit të mbeturinave projekti në fjalë paraqet një ndotje të moderuar të mjedisit në faza të ndryshme të zhvillimit të projektit. Si dhe gjenerimit të mbetjeve organike të cilët do të përdoren nga kryerësit e punimeve, të cilat do të vendosen në kontajnerat të cilat kompania do t'i vendos me qëllim që mbeturinat të mos qarkullojnë në tërë vendpunishten.

**Zhurma** – gjatë kryerjes së punimeve me makineri të rëndë mund të vie deri të emitimi i zhurmës, sidomos gjatë demolimit dhe ndërtimit, i cili mund të jetë jetë shqetësues për të punësuarit dhe banorët përreth objektivit.

Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB. Në vijim po e paraqesim në formë tabelare nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca. Për këtë investitori në bashkëpunim me punëkryerit duhet që të kryej punime prej orës 7.00-17.00 në mënyrë që të mos shqetsoj banorët përreth.

| Zhurma                          | Distanca (m) |    |     |     |
|---------------------------------|--------------|----|-----|-----|
|                                 | 10           | 50 | 100 | 500 |
| 90db-niveli për pajisje moderne | 59           | 45 | 39  | 25  |

**Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Mund të thuhet se ky aktivitet paraqet ndikim significant në banorët e zonës, sepse familjet të cilat jetojnë përreth lokacionit në fjalë, do të ndikohen në një masë të moderuar gjatë kryerjes së punimeve, por që në planin afatgjatë projekti në fjalë ndikon në përmirësimin e ifrastrukturës dhe elementeve tjera të jetesës.

Ndërkaq nga aspektin ekonomik, priten efekte pozitive, sepse planifikohet punësimi i një numri të konsiderueshëm të personave me punë të përhershme tek një numër i konsiderueshëm punëkryerish. Ky projekt ndikon drejtpërdrejt në ekonominë e Gjakovës përmes taksave të ndryshme dhe atë vendore sepse ngërthen një numër të madh të lëndëve të përdorura dhe një numër i konsiderueshëm i kompanive do të kryejnë punime, ndërsa në fazën e operimit do të ofrohen kushte për punësim për banorët vendas.

### 3.1. Masat e marura për mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet

Me qëllim që të sigurohemi se jemi duke realizuar projektin në përputhje me kriteret ligjore gjatë gjithë kohës së përgatitjes së terrenit dhe ndërtimeve duhet të plotësohen kriteret e kontrollës së ajrit nga pluhuri. Poashtu me qëllim të minimizimit të pluhurit dhe ndikuesve tjerë të cilësisë së ajrit gjatë gërmerjes, ngarkimit, shkarkimit, transportimit të këtyre materialeve si në vijim:

- Hapsira e punimeve dhe e pastrimit të saj duhet që paraprakisht të spërkatet me sasi të ujit, gjatë dhe pas operimit me qëllim të mbajtjes së tërë hapsirës të lagur me qëllim që të mos shqetsohen banorët e zonës nga pluhuri.
- Të gjitha materialet ndërtimore duhet të shkarkohen brenda vendpunishtës dhe asesi në skaj rrugës kryesore dhe rrugëve tjera të lagjës.



- Gjithmon para se makineritë të dalin nga hapsira e projektit duhet bërë pastrimi i gomave dhe nëse janë të pluhrosur duhet bërë pastrimi në tërësi, me qëllim të shmangies së shpërhapjes në ambiente jashtë vendpunishtës së materieve kontaminuese.
- Poashtu para se mjetet transportuese të lënë vendpunishtën duhet të sigurohemi se materjali i ngarkuar nuk paraqit rrezik nga derdhja aksidentale, apo nëse është ngarkuar më shumë duhet nivelizuar apo minimalisht të mbulohet me një shtresë nga poliesteri.
- Hapsira në të cilën do të pastrohen makineritë para se ato të leshojnë vendpunishten, duhet që hapsira të jetë e izoluar me material bituminoz dhe uji i gjeneruar gjatë pastrimit të grumbullohet dhe të tërhiqet nga kompanit e licencuara për trajtim të ujrave të ndotur.
- Duhet të sigurohemi se makineritë e angazhuara janë në gjendje të mirë teknike dhe emitimi i gazrave të mos tejkalojë kufijt maksimal të lejuar për SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub> dhe CO.
- Marrja e masave adekuata në harmoni të plotë me ligjin për zhurmën në zona të banimit, hapsira publike dhe për zona në të cilat demolohet/ndërtohet.
- Nëse ndonjë nga makineritë e angazhuara gjeneron zhurmë më të lartë se vlerat kufitare, atëherë atë duhet përshtatur apo ndrruar.
- Të gjitha makineritë e përdorura duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, dhe të mos kenë rrjedhje të karburantëve dhe lubrifikantëve tjerë.
- Mundësisht të hapsira e cila gërmohet të ketë një mbikqyrës të punimeve dhe të merr në konsideratë masat zbutëse.
- Të punësuarit duhet që të punojnë dhe sillen në harmoni me rregullat dhe legjislacionin në fuqi për shëndet dhe siguri në vendpunishte.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë duhet marrë këto masa mbrojtëse në hapësirat e objektit prodhues, duhet që uji i përdorur për kryerje të procesve të ndryshme në vendpunishte të mos ketë rrjedhje të lirë, por të jetë i grumbulluar në gropën septike e cila duhet të jetë e izoluar me material bituminoz.

Seperatorit duhet të përmbush kritetet teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Seperatorit duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mund të kontrollohet rregullisht në mënyrë vizuale uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Përpos sistemit të gypave duhet të ndërtohet edhe sistemi i ujë mbledhësit rreth e përqark rrugëve dhe parkingut të automjeteve dhe sipërfaqeve operationale për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura gjërë në pusin sedimentues. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe separatori, dhe në baze të shkarkimeve të planifikuara dhe vëllimit të gropës septike, rezultoni se ajo përgjatë gjithë kryerjes së punimeve mund të ketë nevojë për shkarkim 1-2 herë.

Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet ndërtuar me tri komora (hapësira). Gropa septike duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe mostrim të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient para lëshuarjes së ujërave në recipient duhet patjetër të dezinfektohen me natrium hipoklorit për mes klorinatorit që duhet ndërtuar. Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Ujërat nga separatori dhe grupa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë. Shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura e paraqesim në vijim. Furnizimi me ujë për pije si dhe për nevoja tjera sanitare bëhet nga ujësjellësi publik.

#### Shema teknologjike e trajtimit të ujërave

Ujërat e të reshurave atmosferike  
nga sipërfaqet operacionale,

Ujërat nga platot e sipërfaqeve  
punuese të implantit dhe objekteve  
përçeluese, rezervat për deponim  
e mazutit, naftës, kalidagës  
generatorit etj

Vaska për neutralizimin  
e ujërave të ndotura me  
kromikate dhe reagent

Sedimentuesi

Separatori i  
Vajrave

Mostrimi

Recipienti

#### 4.0 PËRSHKRIMI I MASAVE ZBUTËSE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Masat për zbutjen / zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis janë paraqitur në tabelën në vijim. Masat e paraqitura do të të implementohen plotësisht.

| Komponenti mjedisor | Potenciali për ndikim negativ                                                                                                                                                                                                            | Veprimi që shkakton ndikimin                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Masat që duhet të ndërmerren                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ajri                | Burim i ndotjes në dhe rreth lokacionit në fjalë është komunikacioni rrugor, ndotja nga emisionet e ngrrohtores gjatë sezonës, si dhe makineritë gërmuese të dheut si dhe materialeve ndërtimore transportuese janë gjeneruesit kryesor. | Gjatë fazës së përgatitjes së terrenit dhe hapjes së bodrumve si dhe konstruktimit vie deri te angazhimi i makinerisë së rëndë, me këtë vie edhe deri tek rritja e emisioneve në ajër. Poashtu vie deri tek rritja e intensitetit të gazrave e cila mund të ndikojnë në shëndetin e të punësuarve dhe banorëve të zonës përreth. Komunikacioni rrugor dhe djegia mazutit gjatë sezonës, si dhe djegia e lëndëve | Mirëmbajtje e makinerisë dhe kontrollimi i cilësi së djegies së karburantit nga ana e tij, në mënyrë që emisionet të jenë brenda parametrave të lejuar.<br>Spërkatja e vendpunishtes me ujë sa herë të jetë e nevojshme në mënyrë që të mos emitohet pluhuri dhe të fluturoj në mjedisin përreth saj. Duhet të sigurohet që pajisjet dhe makineritë e angazhuara do të jenë në gjendje të mirë teknik me qëllim të djegies sa më të mirë të karburantit -zvoglimi i ndotjes në burim. |

|         |                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|         |                                                                                                                                                               | <p>tjera jo cilësore nga ana e ekonomive familjare, sidomos gjatë sezonës. Poashtu ndotja e ajrit mund të vie nga djegia jo e plotë e karburantëve nga makineria e angazhuar në dhe rreth vendpunishtës.</p>                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Uji     | <p>Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësor si dhe nuk njihet si zonë e cila është shumë e pasur me ujëra nëntokësor, me përjashtim gjatë reshjeve të fuqishme..</p> | <p>Uji është komponent bazë për kryerjen e shumicës së aktiviteteve në vendpunishte, andaj gjatë shfrytëzimit duhet që të kihet kujdes i shtuar që të mos ndotet uji nën parametrat e lejuar. Poashtu uji është i nevojshëm edhe për nevojat higjienike të vendpunishtës – të punësuarit.</p> | <p>Për zbutjen e këtyre ndikimeve do të: Ndërtohet gropa septike me separator dhe tërë hapsira do të ketë relief të tillë që rrjedhja e ujrave të ndotur të dërgohet në gropën septike. Do të ndërtohet gropa septike me standarde të larta, të izoluar mirë, dhe të papërshkueshme nga ujrata e papastërta nga pastrimi i hapsirës operuese në vend ndërtim. Gjatë fazës së hapjes së bodrumëve dhe betonimit të platformave dhe ndërtimit, uji sugjerohet të përdoret nga ujësjellësi publik pasi që mundësitë për burim vetanak nuk ekzistojnë. Më pastaj këto ujëra do të largohen përmes autocisternave me sistem pompimi dhe do të lëshohen në kanalizimin e zonës, ndërsa materialet e sedimentuara do të nxjerren nga gropa septike dhe do të dërgohen në deponin regionale të destinuar për këto lloje të mbetjeve. Tërë hapsira operuese duhet të ketë relief të tillë që të gjitha rrjedhjet e ujrave të ndotura dhe ato nga reshjet atmosferike të përcillen deri në gropën septike.</p> |
| Pluhuri | <p>Gjatë procesit të kryerjes së punimeve krijohen sasira relativisht të mëdha pasi që është e</p>                                                            | <p>Aktivizimi i ekskavatorëve për hapjen e themeleve, kamionave për largimin e inerteve dhe</p>                                                                                                                                                                                               | <p>Spërkatja sa herë të jetë e nevojshme me vrushkuj të ujit me qëllim të minimizimit të mundësive për ngritjen e pluhurit dhe ndotjen e hapsirave përreth dhe prishjen e cilësisë së jetesës së banorëve të lagjes.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |

|                                                            |                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>Toka -dheu</b></p>                                   | <p>nevojshme për kryerjen e aktiviteteve sipas rregullave</p> <p>Gjatë kryerjes së punimeve me makineri të rëndë. Potencial për ndikim ekziston te dheu dhe ujërat nëntokësore. Rrugët e</p> | <p>sjelljen e materialeve në vendpunishte</p> <p>Ndikimet paraqiten si pasojë e mos menaxhimit adekuat të makinerisë së përdorur si dhe rrjedhjeve të pakontrolluara në tokë të karburantëve dhe lubrifikantëve tjerë, të cilat mund të depërtojnë në ujra nëntokësor.</p> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <p><b>Pastrimi i gomave të makinerisë së angazhuar</b></p> | <p>fshatit deri në destinimin e huthjes së dheut dhe lëndëve tjera si dhe sjellja e materialeve nga destinime të ndryshme</p>                                                                | <p>Gomat e automjeteve transportuese dhe makinerive tjera</p>                                                                                                                                                                                                              | <p>Me qëllim evitimin e nxjerrjes së dheut përmes rrotave të makinerive të angazhuara nga vendpunimi në rrugët e qyteti, investitori do të instalojë një autolarje me qëllim të pastrimit të rrotave të makinerisë para se ato të lëshojnë vendpunishten. Hapsira në të cilën kryhet pastrimi i gomave të automjeteve transportuese sa herë që lëshojnë vendpunishten, dhe në raste të tërë kamionit duhet të ketë ramje që uji i ndotur të përcillet në gropën septike.</p> <p>Është masë e patjetërsueshme që, makineritë dhe kamionat e angazhuara t'ju pastrohen rrotat, apo të pastrohen në tërësi nëse janë të pluhurosura dhe nëse ekziston rreziku i fluturimit të pluhurit në hapsira publike.</p> |

|                       |                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Pamja vizuale e zonës | Potencial për prishje dhe njëkohësisht e të imazhit të vizuel të zonës.                                                                          | Përgatitja e hapsirës punuese dhe kryerja e aktiviteteve gjurmuese dhe transportuese.                                                                                                                                                                                                                                                                | Investitori me qëllim të mbajtjes së zonës në nivel të pranueshëm vizuel duhet që rrethimi i hapsirës punuese të bëhet sa më me shije dhe mos lejohet casje të dukshme në vendpunishte përveq hyrje daljeve. Pra, vendpunishtja t'ju përmbahet kushteve dhe detyrimeve që dalin në përshkrimi teknik i projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Mbeturinat            | Nëse nuk menaxhohen si duhet do të paraqesin ndikime signifikante në mjedisin jetësor.                                                           | Mbeturinat organike që gjenerohen gjatë kryerjes së punimeve, si dhe mbetjet e materialit ndërtimor dhe paketimet që i shoqërojnë ato gjatë transportit.                                                                                                                                                                                             | Vendosja e kontajnerave të veçantë për mbetje organike dhe kontajnera të veçantë për mbetje inerte si dhe të bëhet transportimi i tyre nga kompanit e licencuara deri në deponitë e dedikuara për natyrën e këtyre mbetjeve në harmoni me legjislacionin në fuqi si: Ligji për mbeturina (02/L -30), Udhëzimin administrativ Nr.01/2017 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Zhurma                | Mundësi e madhe që të kemi ndotje signifikative sidomos gjatë gjurmimeve të terreni për hapjen e themeleve – angazhimi i ekskavatorëve të rëndë. | Gërmimi, largimi i dheut dhe transportimi i materjeve të thëmuara paraprakisht është pjesa më e rëndësishme e cila gjeneron shumicën e ndotjeve, posaqërisht ndotja nga zhurma. Aktivizimi i makinerisë gnyese dhe transportuese ndikon që vlerat maksimale në burim të tejkalohen, bile edhe në pjesën e pasme të objektit dhe lokacionit në fjalë. | Niveli i zhurmës do të ndikojë që në dhe rreth hapsirës së punishtës, dhe me qëllim që ndotja jashtë punishtës të jetë brenda parametrave të lejuar për zona të banimit brenda orarit të punës duhet që investitori të bëjë rrethimin e tërë hapsirës dhe mundësisht me bōjë thurjen me gardh me lartësi sa më të madhe. Nëse do të kemi rritje të zhurmës në hapsirën operuese nga makinerit dhe gjeneratori, atëherë sugjerohet që të punësuarit të përdorin izolator të zhurmës. Nëse tejkalohen vlerat maksimale të zhurmës nga makinerit e përdorura Poashtu nevojitet që investitori në bashkëpunim me punëkryersin të jetë strikt në orarin e punës prej orës 7.00 -17.00. |

|                                                         |                                                                                            |                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shëndeti i të punësuarve dhe banorëve përreth objekteve | Potencial i modernuara dhe brenda parametrave                                              | Punët në hapsirat e objekteve të prodhimit në të gjitha fazat e saj | Të punësuarit do të pajisen me mjete pune adekuate sipas rregullave dhe dispozitave në f për mbrojtjen e shëndetit dhe rrezikut në punë. Spërkatje me vrushkuj të ujit me qëllim që plut i krijuar gjatë rrënimeve të mos afektojë banorë përreth projektit. |
| Rreziku nga zjarri dhe rreziqet tjera                   | Potencial për rrezik nga zjarri apo kryerje e punimeve pa kritere e pajisje adekuate pune. | Ndezje e pakontrolluar e mbetjeve në vend punishte.                 | Plan i menaxhimit të rrezikut nga zjarri në harmoni me ligjin për emergjencë. Zbatimi i kritereve dhe pajisjeve profesionale për punë.                                                                                                                       |

## KONKLUZIONE

Projekti teknik dhe arkitektonik si dhe vlerësimi paraprakë lidhur me ndikimet e mundshëm në mjedis në të gjitha fazat e kryerjes së punimeve të objektit: Halla prodhuese për llaçe të fasadave dhe ajo për elemente të ndryshme nga materiali PVC, do të menaxhohet duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi si: për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjeve tjera që derivojnë nga ky ligj: ajër, ujë, tokë, zhurmë, energji, trashëgimi kulturore dhe faktorin njeri dhe korelacioni i ndërsjellë.

Të gjithë palët e involvuar në projektin në fjalë janë të vetëdijshëm për çështjet mjedisore dhe nevojën e patjetërsueshme për të mbrojtur atë gjatë fazës së punimeve përgatitore, fazës së ndërtimeve dhe fazës operuese.

Bazuar në studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, projektit teknik si dhe duke lu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludohet si në vijim:

- Përgatitja e terrenit nën masat e sugjeruara mund të ketë ndikime të moderuara dhe nuk do të ofrojë kërcënime shqetsues për banorët e zonës.
- Implementimi i masave zbutëse për komponentët e caktuara të cekura më lartë mundëson që projekti të zhvillohet brenda parametrave të lejuara për emisionet dhe imisionet.
- Ndikimi i pluhurit dhe emisioneve të SOx dhe NOX nga makinat grryese dhe kamionat transportues do të jetë brenda parametrave të pranueshëm.
- Mirëmbajtja dhe gjendja e mirë teknike e makinerisë do të mundësojnë që emisionet të jenë brenda parametrave të lejuara për emisionet.
- Grumbullimi i të gjitha ujrave në gropë septike dhe trajtimi i mëvonshëm i tyre është bazë e sigurt se cilësia e ujrave nuk kërcënohet nga projekti në fjalë.
- Ndërtimi i objekteve në fjalë, funksionalizimi dhe operimi i tij, është në interes të vet investitorit për të zhvilluar afarizëm si dhe në interes të vetë komunës përmes punësimit të një numri punëtorësh në faza të ndryshme.
- Duke e pasur parasysh, natyrën e projektit, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet e këtij projekti në mjedisin lokal janë minimale dhe të menaxhueshme, të riparueshme dhe krejtësisht të kontrollueshme.
- Me kryerjen profesionale të punimeve, me respektimin e plotë të projektit teknik, me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, ky projekt konsiderohet krejtësisht i pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

**Bashkangjitur këtij Raporti janë dokumentet vijuese:**

- Projekti ideor i objekteve
- Kopja e planit dhe certifikata e pronës

Rogovë, Mars 2020

**INVESTITORI,**

HAINZE sh.p.k. Rogovë  
Pronar: Fitim HOTI





VLERËSIMI

ING VLERËSIMI SH.P.K

Nr. Unik: 811386334

Llogaria: NLB: 1705017400129771

Malishevë Kosovë 240000

Tel : 049/637-668

E-mail: [ingvleresime@gmail.com](mailto:ingvleresime@gmail.com)

[armendgeodesy@gmail.com](mailto:armendgeodesy@gmail.com)

Nr.006/2020  
Malishevë 13.08.2020

---

Për : **Fitim Hoti nga fshati Rugovë Komuna Gjakovë**

Komuna:  
Zona Kadastrale

Gjakovë  
Rugovë

### RAPORT VLERËSIMI

Ekspert Vlerësues  
Armend Krasniqi Nr.VP-143

---

Malishevë 13.08.2020

# RAPORT VLERËSIMI

Parcela: P-70713071-00400-5

PASURI E PALUAJTSHME



KOMUNA: GJAKOVË

ZONA KADASTRALE: RUGOVË I

PRONËSIA: P.SH.KUVENDI KOMONES

POROSITËSI: Fitim Hoti nga fshati Rogovë

Përgatiti raportin: Armend Krasniqi, Vlerësues i licencuar i shkallës së parë "A" Nr.VP-143

Vlera totale për sipërfaqen 25788m<sup>2</sup> është rreth : **48,997.00 €**

*Armend Krasniqi*



Data e Inspektimit: 12.08.2020

Data e Vlerësimit: 13.08.2020

## **PËRNIBAJTJA**

### **Vështrimi i pronës**

#### **Letra Shoqëruese**

- 1. Përkufizime dhe rezervime**
  - 1.1 Vlera e Tregut të Hapur
  - 1.2 Çmimi i Përafërt i Kufizuar
  - 1.3 Kostoja e Ndërtimit
  - 1.4 Kostot e shitjes
  - 1.5 Tatimet
  - 1.6 Dokumentet e pronësisë
  - 1.7 Inspektimi
- 2. Baza e Vlerësimit**
- 3. Raport vlerësimi**
  - 3.1 Data e inspektimit dhe vlerësimit
  - 3.2 Vendndodhja
    - 3.2.1 Komuna Gjakovë
    - 3.2.2 Zona Kadastrale Rogovë I
- 4. Përshkrimi i Pronës**
  - 4.1 Statusi ligjor i pronës
  - 4.2 Lokacioni i pronës (Harta)
- 5. Vlerësimi**
  - 5.1 Baza e vlerësimit dhe metoda e përdorur
  - 5.2 Llogaritja e vlerës së tregut të hapur:
  - 5.3 Agjustimet/ Krahasimet
- 6. Pronësia**
  - 6.1 Infrastruktura
  - 6.2 Hipotekat dhe ngarkesat tjera
- 7. Kushtet**
- 8. Lidhjet**
  - Foto të pronës

Malishevë me datë : 13.08.2020

Drejtuar: Fitim Hoti

Nga: Eksperti : Armend Krasniqi

*Të nderuar Znj/Z.*

Ne përputhje me kërkesën tuaj, kemi përgatitur raportin e vlerësimit për pronën e z. Fitim Hoti, zonën Rogovë, Komuna –Gjakovë

Ne përputhje me të dhënat tuaja dhe me inspektimet dhe gjykimet e mia, kam përgatitur vlerësimin e mëposhtëm për përcaktimin e vlerës sa me reale të pronës.

Vlerësimi merri parasysh vlerën e tregut dhe ka për bazë vlerën që kanë pronat që vlerësohen deri në momentin e kryerjes së vlerësimit.

Në këtë vlerësim do të jap opinionin tim nëbi vlerën e tregut dhe interesit ligjor duke supozuar se klienti është pronar i tyre dhe se titulli ligjor është i saktë i plotë dhe mund të vërtetohet.

Raporti vlerësimit është konfidencial dhe vetëm për përdorim dhe qëllime të "Fitim Hoti," për qëllime specifike të cilave u referohet. Ai mund të përdoret nga këshilltar të tjerë profesionist për të ndihmuar në lidhje me sa më sipër.

Raporti i Vlerësimit shoqërohet me dokumentacionin tekniko-ligjor:

- Foto të pronës
- Skicat e parcelave dhe objekteve
- Harta e Gjakovës

Raport vlerësimi është përgatitur nga Armend Krasniqi Vlerësues të Licencuar.

Duke pasur parasysh instruksionet tuaja në lidhje me pronën dhe pasi kemi bërë inspektimet në vend, investigimet dhe kërkimet e nevojshme kam kënaqësinë t'ju raportojmë si më poshtë.

## 1. PËRKUFIZIME DHE REZERVIME

